



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“TVN CABLE –TV” SH.P.K.  
Numri i biznesit – 601216577  
Person i autorizuar– Naim RRUSTEMAJ  
OK TVN CABLE TV  
Prishtinë

Ref:1904/495/LIC/ni

### VENDIM

*për revokimin e vendimit për licencim të Operatorit të Shpërndarjes (OSH) TVN Cable TV, me seli në Prishtinë*

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TVN Cable TV është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, me seli në Prishtinë. KPM, me datën 21 shtator 2015, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin e shpërndarjes TVN Cable TV.
3. Më datën 22 shtator 2015, Departamenti i Licencimit, përmes e-malit i ka përcjllë kandidati vendimin për licencim të operatorit të shpërndarjes TVN Cable TV në e-mailin zyrtar të këtij operatori.
4. Pronarët e operatorit të shpërndarjes TVN Cable TV, shtetas të Rumanisë dhe të Republikës së Kosovës, nuk kanë nënshkruar pakon e licencës për operator të shpërndarjes

#### Arsyetimi

5. Komisioni konstaton se, që nga marrja e vendimit për licencimin e operatorit të shpërndarjes TVN Cable TV, nga ana e Komisionit, dhe përcjellja e tij tek i licencuari, pronarët e këtij operatori, asnjëherë nuk kanë shprehur interesim dhe nuk janë paraqitur në zyrën e KPM-së lidhur me nënshkrimin e pakos së licencës.
6. Departamenti i Licencimit ka provuar që, të kontaktoj te licencuarin, nëpërmjet numrave të telefonit për kontakt, të paraqitur në fletë aplikacion lidhur me përgatitjen e pakos së licencës dhe obligimeve ndaj tarifës për licencë, mirëpo, nuk ka arritur që të kontaktoj me të licencuarin.
7. Përmes aplikacionit, i licencuari ka deklaruar se fillimisht, planifikon të operojë në qytete si: Prizren, Mitrovicë dhe Skenderaj, mirëpo, Komisioni nuk ka pas asnjë informacion se i licencuari ka filluar me veprimtarin e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
8. Komisioni konstaton se, në fillim të çdo viti i ka dërguar letrën përcjellëse dhe faturën operatorit të shpërndarjes TVN Cable TV, lidhur me shlyerjen e obligimeve ndaj tarifës vjetore të licencës, mirëpo, i licencuari nuk ka arritur që të shlyej asnjë detyrim ndaj tarifës vjetore të licencës.

### VENDIM

9. Komisioni, në takimin e tij më datë 21 mars 2019, merr vendim për revokimin e vendimit për licencimin e operatorit të shpërndarjes TVN Cable TV, vendimit me numër të referencës: 1508/1038/LIC/11 të datës 21 shtator 2015, ndërsa, shlyerja e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



21. 03. 2019  
datë